



SAMITI I BERZH MBI INVESTIMET NË BALLKANIN PERËNDIMOR




Së bashku me Kryeministrin Rama, Ministria Denaj mori pjesë në Samitin e Investimeve për Ballkanin Perëndimor organizuar nga BERZH, ku diskutimet u fokusuan në rajonin e Ballkanit si një treg i përbashkët rajonal, që tërheq investitorë të rinj dhe sjell risi për ekonominë. Programet kryesore të ndërlidhjes tashmë në zhvillim dhe projektet e reja infrastrukturore kanë përkushtimin maksimal të Qeverisë Shqiptare, si një instrument zhvillimi dhe integrimi ekonomik në rajon dhe Europë. Në takimin me Z. Chakrabarti, President i BERZH-it, u shpreh mirënjohja për mbështetjen e vazhdueshme ndaj qytetarëve shqiptarë. Qeveria Shqiptare është e angazhuar t'i bëjë realitet projektet rajonale edhe përmes unifikimit të procedurave dhe reduktimit të burokracive, si dhe bashkëpunimit me Bashkimin Evropian dhe Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

TAKIMET E KONSTITUENCËS TË FMN DHE BB



Ministria Denaj, së bashku me Guvernatorin e BSH, morën pjesë në Mbledhjen e Konstituencës të FMN dhe BB në Greqi. Ministria prezantoi situatën ekonomike të Shqipërisë dhe perspektivën e Qeverisë në nivel kombëtar dhe rajonal. Ajo theksoi se ruajtja e parametrevë makroekonomikë dhe ecuria e konsolidimit fiskal mbeten prioritare, ndërsa vlerësoi pozitivisht ecurinë e parametrevë makro-fiskalë, duke vlerësuar reduktimin e borxhit, ruajtjen e balancës primare pozitive dhe zbatimin e suksesshëm të reformës së menaxhimit të financave publike, si parakushte të qëndrueshmërisë së një ekonomie në zgjerim të vazhdueshëm. Ministria falënderoi partnerët për mbështetjen në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe kapërcimin e sfidës së Rindërtimit.

BASHKËPUNIMI EKONOMIK SHQIPËRI- NORVEGJI



Intensifikimi i marrëdhënieve ekonomike mes Shqipërisë dhe Gjermanisë u diskutua gjatë takimit që Ministria Denaj zhvilloi me Ambasadorin e Norvegjisë, z. Jens Erik Grondahl. Ministria bëri një prezantim të zhvillimeve kryesore ekonomike dhe financiare të vendit tonë dhe theksoi se fokusi për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë vendase do të mbetet tërheqja e investimeve të huaja direkte, në sektorët ku ekonomia shqiptare ka potencial të pasfrytëzuar, si sektori i energjisë së rinovueshme, sektori i turizmit, sektori i agrobiznesit, sektori i infrastrukturës, formimi dhe arsimit profesional e teknologjia e informacionit. Ministria tha se Shqipëria ka përshtatur një kuadër ligjor liberal me qëllim krijimin e një klime të favorshme investimi për investitorët e huaj dhe projektligji i unifikuar për investimet do të ofrojë më shumë garanci për investitorët e huaj.

OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE ONLINE



Mbarëvajtja e procesit të ofrimit të shërbimeve publike online u diskutua në takimet e zhvilluara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me drejtuesit e institucioneve të varësisë së MFE-së në qarqet Durrës dhe Shkodër, ku të pranishëm ishin dhe prefektët e dy qarqeve. Zv.Ministria Belinda Ikonovi vuri theksin në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe respektimin e afateve kohore, ndërsa kërkoi angazhimin e punonjësve të administratës në përbushjen e detyrimeve përkatëse. Që nga data 1 janar 2020 janë 472 shërbime që ofrohen online dhe 500 të tjera do të ofrohen që nga muaji qershor, duke synuar që 95% e shërbimeve totale publike të mundësohen online deri në fund të vitit. Gjatë takimeve u nënvizua rëndësia që qytetarët dhe bizneset të informohen dhe asistohen mbi ofrimin e shërbimeve online, në mënyrë që të rritet numri i përfutësve të këtyre shërbimeve, duke synuar shkurtimin e afateve kohore dhe eliminimin e sporteve fizike.

LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT NË TREGUN E PUNËS



Inspektoriati i Punës ka ushtruar kontrole në 1350 subjekte, me 24 881 vende pune apo punëmarrës të konstatuar në punë, gjatë periudhës 1 janar-26 shkurt 2020. Gjatë inspektimeve janë evidentuar 80 punëmarrës informal dhe rreth 91.3% e tyre janë siguruar brenda procesit inspektues, ndërkohë për 7 punonjës informal janë deleguar pranë degëve të tatim-taksave për veprime të mëtejshme mbi sigurimin e tyre. Për shkelje të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës evidentuar në inspektimet e realizuara në këtë periudhë janë marrë 218 masa administrative. Për muajin mars, janë planifikuar inspektime në subjekte me aktivitet fasoni, sektor i cili ka të punësuar një numër të konsiderueshëm punëmarrësve femra, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për punësim të denjë të tyre. Inspektimi do të shoqërohet me këshillime e informim mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke shpërndarë edhe fletëpalosje për këtë qëllim.

ADMINISTRATA TATIMORE NË TERREN



Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka ushtruar 900 kontrole në terren gjatë periudhës 13-26 shkurt 2020. Nga kontrollet e ushtruara janë konstatuar 118 shkelje të legjislacionit tatimor, nga të cilat: 13 subjekte të paregjistruara; 15 tatimpagues të penalizuar për shkeljen e moslëshimit të kuponit tatimor (rasti i parë); 13 tatimpagues me punonjës të padeklaruar; 7 tatimpagues janë konstatuar se nuk kanë pasur të instaluar pajisjet fiskale dhe 3 të tjerë nuk mbanin pajisjen fiskale në gjendje pune; 25 tatimpagues janë konstatuar se dispononin mallra pa dokumentacion tatimor; 2 tatimpagues bllokuan ambientet për 30 ditë kalendarike për moslëshim kuponit tatimor (hera e dytë).

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



340 është numri i personave që janë punësuar me ndërmjetësimin e zyrave të Punës gjatë periudhës 21-27 shkurt 2020.